



Prishtinë, 24 shtator 2018  
Kodi i ZRRE-së: V\_1029\_2018

#### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

##### Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtritshme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve;
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vet-konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në Lokacionin Llapnasellë, ZK Llapnasellë, me kapacitet të instaluar prej 60 kW në Komunën e Graçanicës, të datës 05.09.2018 me nr. prot. 398/2018 të "Agro Trade" SH.P.K., me adresë: Graçanicë, Komuna e Graçanicës Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur më 24 shtator 2018 nxori këtë:

## V E N D I M

### PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM

- I. **APROVOHET**- kërkesa e "Agro Trade" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vet – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në Lokacionin Llapnasellë, me kapacitet të instaluar prej **60 kW** , në ngastrat kadastrave Nr. 1774/2 ZK Llapnasellë, Komuna e Graçanicës.
- II. **OBLIGOHET** -"Agro Trade" SH.P.K., me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DFE-9026287 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vet-konsum, të parashtoj kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.
- III. ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas përqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV. "Agro Trade" SH.P.K., do të lidh Marrëveshje për vet-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.




## Arsyetim

- ZRRE, me datë 05.09.2018 nga “Agro Trade” SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vet – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në Lokacionin Llapnasellë, me kapacitet të instaluar prej **60 kW**, në ngastrat kadastrave Nr. 1774/2 ZK Llapnasellë, Komuna e Graçanicës.
  - “Agro Trade” SH.P.K., s’bashku me aplikacioni ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetorë të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të paj sjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergjetik nr. 8325 të datës 13.08.2018 të lëshuar nga KEDS SH.A., dhe Pëlqimin nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Graçanicës.
  - Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së “Agro Trade” SH.P.K., dhe dëshmime të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vet-konsum nga panelet solare/fotovoltaike në Lokacionin Llapnasellë, me kapacitet të instaluar prej **60 kW**, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

  
Arsim Janova, u.d. Kryesues

  
Besim Sejfiqaj, anëtar

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- Komunës së Graçanicës,
- KEDS SH.A.,dhe
- Arkivit të ZRRE-së